



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

AGJENCIONI I MBROJTJES SË MJEDISIT TË KOSOVËS/
INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS



BULETINI HIDRO- KLIMATOLOGJIK

TREMUJORI I PARË 2016, Nr.1

Prishtinë, 2016

I nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që përmes veb faqes së Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) <http://www.ammk-rks.net/> të ju ofrojmë mundësinë që të keni qasje në informacionet e dhëna në numrin e parë të buletinit hidro-klimatologjik. Përgatitja e këtij buletini është kontribut i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, ndërsa publikimin e tij në veb faqen e ammk e mundësoi kryeshefi ekzekutiv i AMMK.

Ngritja e nivelit të informimit cilësor rreth elementeve dhe dukurive hidrologjike, klimatologjike dhe dukurive ekstreme të motit ka qenë një nga arsyet që nxiti publikimin e këtij buletini që do të bëhet në bazë tremujore.

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është që të sjellim para jush informata të rëndësishme rreth gjendjes hidrologjike , meteorologjike dhe klimatologjike, por edhe të paraqesim, projektet dhe aktivitetet e institutit hidrometeorologjik.

Shpresojmë se ky buletin do të bëhet një burim i rëndësishëm për t'ju ofruar informata të përditësuara dhe interesante rreth gjendjes hidrologjike dhe klimatologjike në Kosovë.

Dr.sci. Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv i
Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

.....

Ing/Msc. Letafete Latifi , Drejtore e Institutit
Hidrometeorologjik të Kosovës

.....

PARATHËNJE

Hartimi i Buletinit Hidrologjik dhe Klimatologjik është i bazuar në te dhënat e mbledhura nga monitorimi hidrologjik dhe meteorologjik në Kosovë gjatë periudhës 01 Janar-31 Mars 2016, realizuar nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovë .

Në Buletinin Hidrologjik dhe klimatologjik është pasqyruar gjendja hidrologjike, klimatologjike dhe rastet e paraqitjes se dukurive ekstreme te motit, janë dhënë fakte nga tereni mbi nivelet e ujrave në lumenjtë e Kosovës, sasia e reshjeve dhe indeksi i standardizimit të reshjeve(SPI) si dhe fakte mbi gjendjen klimatike qe përfshinë temperaturat mesatare , minimale dhe maksimale te mesatareve mujore , orët me shkëlqim të diellit dhe ditët me reshje bore dhe shiu gjatë tremujorit të parë të vitit 2016. Janë dhënë te dhëna dhe informacione mbi rastet e vërshimeve në Kosovë dhe zonat e përfshira nga vërshimet qe kanë ndodhë gjatë periudhës për të cilën i referohemi ne këtë bulletin.

Qellimi i këtij buletini është qe të mbajë të informuar institucionet qeveritare dhe joqeveritare për gjendjen hidrologjike në Kosovë, kushtet klimatike dhe dukuritë ekstreme ne meyrë që institucionet relevante dhe politikëbërësit të orientojnë drejt projektete dhe planet e tyre të veprimit.

Është e rëndësishme të theksohet se ky është numri i parë i buletinit hidrologjik dhe klimatologjik, si dhe është hera e parë që Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës harton një bulletin të tillë.


HIDROMETEOROLOGJIA E KOSOVËS GJATË PERIUDHËS JANAR-MARS 2016

GJENDJA HIDROLOGJIKE NË KOSOVË

Gjendja hidrologjike në Kosovë monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës përmes Rrjetit të Monitorimit Hidrologjik.

Rrjeti hidrologjik është një numër i integruar i stacioneve matëse nëpër lumenj ku kryhen matje të vazhdueshme kualitative dhe të koordinuara mbi vëllimin e ujit. Grumbullimi i të dhënave hidrologjike bëhet në stacione hidrometrike, numri i të cilëve na jep mundësi të llogaritim regjimin e ujeshmërisë së rrjetit hidrografik të Kosovës.

Aktualisht në rrjetin e monitorimit hidrometrik të ujërave sipërfaqësorë, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës i ka 27 stacione hidrometrike (hartat), në të cilat janë të vendosura pajisjet sensorike, të cilat e bëjnë regjistrimin automatik të nivelit (h) dhe temperaturës (t) së ujit në interval kohor çdo 15min dhe 1 orë.



Harta 1. Rrjeti i stacioneve hidrometrike të Kosovës

Prej këtyre stacioneve 7 janë me qasje në kohë reale (GPRS), të cilat e bëjnë transferimin e të dhënave në serverin qendrorë të IHMK në Prishtinë. Nga të dhënat e regjistruara në stacionet hidrometrike për indikatorët kryesorë hidrologjik, gjatë tre muajorit të parë të vitit 2016 tregojnë, që lëkundjet e niveleve dhe prurjeve të ujit në profilet hidrometrike, kanë qenë mjaft dinamike (tabela 2), duke krahasuar me periudhat paraprake. Këto kanë kushtëzuar që gjatë kësaj periudhe të paraqiten nivelet e larta dhe vërshime të lumenjve dhe degëve të tyre, nëpër disa pjesë të Kosovës.

Tabela 1 Nivelet mesatare, maksimale dhe minimale (cm), për periudhën janar, shkurt, mars 2016¹

Nr	Kodi	Stacioni	mes. I-III	max. I-III	min. I-III	H_min AP	H_max AP	Data min	Data max
1	RV0101	Berkovë	1,07	1,35	0,92	0,828	2,108	2.2.2016	8.3.2016
2	RV0102	Drelaj	0,76	1,13	0,59	0,443	1,427	2.1.2016	15.2.2016
3	RV0103	Grykë	0,75	1,01	0,59	0,352	1,237	1.1.2016	15.2.2016
4	RV0104	Klinë	0,72	1,23	0,57	0,486	2,461	1.1.2016	8.3.2016
5	RV0105	Mirushë	0,96	2,14	0,69	0,545	3,65	1.1.2016	6.1.2016
6	RV0106	Deçan	0,63	0,79	0,52	0,459	1,061	30.3.2016	15.2.2016
7	RV0107	Këpuz	1,49	2,60	1,13	0,855	4,512	1.1.2016	8.3.2016
8	RV0108	Gjakovë	0,90	1,77	0,55	0,369	3,399	1.1.2016	7.3.2016
9	RV0109	Piranë	1,31	2,09	1,11	1,023	3,882	1.1.2016	6.1.2016
10	RV0110	Gjonaj	2,57	4,15	1,91	1,559	5,016	1.1.2016	8.3.2016
11	RV0111	Prizren*	-	-	-	-	-	-	-
12	RV0112	Vllashnje*	-	-	-	-	-	-	-
13	RV0201	Drenas	1,65	2,31	1,20	0,989	2,768	1.1.2016	6.1.2016
14	RV0202	Lluzhan	1,29	2,06	1,02	0,811	3,515	1.1.2016	14.3.2016
15	RV0203	Nedakovc	1,77	2,69	1,48	1,371	3,185	1.1.2016	12.3.2016
16	RV0204	Vragoli	1,04	2,11	0,66	0,466	2,681	4.1.2016	11.3.2016
17	RV0205	Caraleva	0,33	0,82	0,26	0,180	1,726	1.1.2016	11.3.2016
18	RV0206	Millosev	1,99	2,40	1,07	0,979	3,975	1.1.2016	14.3.2016
19	RV0207	Prelez**	-	-	-	-	-	-	-
20	RV0208	Leposaviç	2,12	3,06	1,65	1,386	4,043	1.1.2016	13.3.2016
21	RV0301	Konqul	3,11	4,72	2,54	2,124	6,101	1.1.2016	11.3.2016
22	RV0302	Domarovc	0,66	3,24	0,84	0,65	3,300	1.1.2016	11.3.2016
23	RV0303	Viti	0,71	0,93	0,61	0,502	1,507	1.1.2016	7.3.2016
24	RV0401	Kaçanik	0,50	0,82	0,38	0,308	1,274	1.1.2016	8.3.2016
25	RV0402	Brod	0,76	0,93	0,61	0,504	1,171	1.1.2016	6.1.2016
26	RV0403	Hani Elezit	0,62	0,98	0,48	0,397	1,456	1.1.2016	7.3.2016
27	RV0501	Mlikë	0,90	1,02	0,83	0,635	1,235	6.3.2016	15.2.2016

Nga të dhënat e tabelës (1), vërejmë se të tre muajt kanë qenë të pasur me reshje, por në veçanti marsi ka qenë i përcjellur me reshje të dendura të cilat kanë kushtëzuar që edhe nivelet nëpër lumenj të rriten gjerë në kapacitetet maksimale të tyre, ku shumica e tyre kanë dalë nga shtrati duke shkaktuar vërshime.

Në 15 stacione maksimumi i niveleve ka qenë gjatë muajit mars, edhe atë më datë 08/03/2016, në shumicën e lumenjve të pellgut të Drinit të Bardhë (Bërkovë, Klinë Këpuz, Gjonaj), ndërsa në pellgun e Ibrit në mesë të datës 11-14/03/2016, (përjashtim bënë lumi Drenica 06/03/2016),


¹ H_min_AP dhe h_max_AP, parapet nivelin më të lartë të regjistruar gjatë periudhës referuese (I-III)

*Për shkaqe teknike nuk janë llogaritur për këtë periudhë

**Për shkaqe sigurie personeli i sektorit të IHMKS nuk ka arritur që të merr të dhënat për këtë periudhë


ndërsa në Lepenc kemi një dallim në ndryshimin e niveleve sipas muajve, në Moravën e Binçës, nivelet kanë arritur amplitudën maksimale nga data 07 – 11/04/2016.

Në 4 stacione hidrometrike, nivelet maksimale kanë arritur gjatë muajit shkurt (Drelaj, Grykë e Rugovës, Deçan dhe Mlikë), dhe në 4 lumenj (Mirushë, Piranë, Brod, Drenas) gjatë muajit Janar. Kjo është në përputhje të plotë me shpërndarjen kohore dhe hapësinore, të reshjeve si dhe me orografinë, përbërjen gjeologjike dhe mbulueshmërin bimore të territorit të vendit, të cilat kushtëzojnë lëvizjen e ujit në shtretërit e tyre.



Grafiku 1. Nivelet mesatare gjatë muajve janar-shkurt- mars 2016

Gjatë kësaj periudhe, nivelet mesatare më të larta kanë qenë në lumin Morava e Binçës, stacioni hidrologjik në Konçul, me vlerë 311 cm, pastaj Drini Bardhë në Gjonaj 257 cm, Ibri Leposaviç 212 cm, Llapi Milloshevë 199 cm, Sitnica, në Nedakoc 177 cm, Drenica në Drenas 165 cm etj.



Grafiku 2. Nivelet mesatare gjatë muajve I-II-III 2016 në raport me mesataren 1960/1990

Nga grafiku (2), vërejmë që nivelet mesatare gjatë muajve: Janar-shkurt-mars 2016, krahasuar me periudhën 1960/1990, në tre stacione², një më të larta se normalja, edhe atë, në Drinin e Bardhë niveli është për 116.3 cm (45.2 %), më i lartë se mesatarja, për Ibrin 64.6 cm (30.4 %), për lumin Morava e Binçes 242.5 (77.9 %)³

Ndërsa vetëm në Lepenci janë regjistruar nivele më të ultë në raport me mesataren shumëvjeçare edhe atë për – 26.9 apo -24.7 %.

² Janë stacione të cilat e përfshijnë tërë pellgun (stacione kufitare – dalëse nga territori i Kosovës me vendet fqinje)

³ Te stacioni hidrometrik në Moravën e Binçes është ndërruar pozicioni i stacionit në vitin 2015, prandaj nuk është i njëjti profil, por kjo nuk e ndryshon në masë nivelin e ujit për periudhën e dhënë.

Gjendja meteorologjike dhe klimatologjike në Kosovë monitorohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës përmes rrjetit të monitorimit meteorologjik dhe rrjetit për monitorimit e reshjeve (shih hartën 2).


Rrjeti meteorologjik është një numër i integruar i stacioneve matëse i shpërndarë në gjithë territorin e Kosovës ku kryhen matje kualitative dhe të koordinuara mbi specifikat e lokacioneve. Arkivimi i të dhënave meteorologjike bëhet në softuerin qendror (MCH) të IHMK, përmes të cilit bëhet edhe përpunimi i të dhënave.

Analiza e të dhënave të regjistruara në stacionet meteorologjike gjatë periudhës për të cilën i referohemi në këtë buletin na bënë të kuptojmë se qfar e karakterizon periudhën janar-Mars 2016.


Temperatura e ajrit- karakterizohet me temperatura të mesatare mujore, mesatare mujore e temperatura minimale, mesatare mujore e temperatura maksimale dhe me numrin e ditëve me temperatura mbi ose nën pragun e përcaktuar (varësisht nga sezoni dhe klima karakteristike).

Në vazhdim janë dhënë grafikonet e temperaturave karakteristike të ajrit (grafikoni 3 dhe 4) për stacionet kryesore klimatologjike, përfaqësuese të regjionit të rrafshit të Kosovës/pellgut të Ibrit-stc. në Prishtina, rrafshit të Dukagjinit/Pellgut të Drinit të bardhë-stac. në Peja dhe Pellgut të Lepencit-stac. në Ferizaj.


Nga analiza e grafikoni 3 vërehet se periudha Janar-Mars 2016 është karakterizuar me temperatura të lartë gjatë muajit shkurt krahasuar me temperatura mesatare mujore të viteve 1960/1990. Është vërejtë se muaji shkurt ka qenë shkurt më i nxehtë nga kur datojnë matjet meteorologjike në Kosovë. Karakteristikë tjetër për këtë periudhë është se muaji shkurt ka qenë më i nxehtë se muaji marsë gjë që nuk është e zakonshme që muaji shkurt të jetë më i nxehtë se muaji mars. Temperatura më e ulët e regjistruar gjatë kësaj periudhe ka qenë -20°C gjatë muajit Janar, ndërsa temperatura më e nxehtë dhe karakteristike



Harta2. Rrjeti i stacioneve meteorologjike




Grafiku 3. Temperatura mesatare mujore në stacionet meteorologjike



Grafiku 4. mesatarja mujore e temperaturës minimale dhe maksimale të ajrit

Numri i ditëve me temperatura nën 0°C -periudha për të cilën jemi referuar në këtë buletin karakterizohet edhe me numrin e ditëve me temperatura nën 0°C , ku gjatë muajit janar kanë qenë 21 ditë me temperaturë nën 0°C në Prishtinë , 20 ditë në Pejë dhe 23 ditë në Ferizajë. Ndërsa muaji shkurtë është karakteristik edhe me numër të vogël të ditëve me temperaturë nën 0°C krahasuar më muajin marsë shih graf. 5



Grfiku5. Numri i diteve me temperaturë nën 0°C e regjistruar ne stacionet klimatologjike

Numri i orëve me shkëlqim të diellit- gjatë periudha Janar-Mars 2016 në Prishtinë ka pasë 306 h me diel, ndërsa në Ferizaj 272 h.

Shpejtësia e erës- Eshte karakteristike se gjate janarit dhe shkurtit janë paraqitë erëra të forta ku shpejtësia maksimale ka arrite ne 22.4 m/sec ne Ferizaj ,ndersa në Prishtinë 16 m/sec dhe në Pejë 10m/sec.(zonë urbane) gjatë muajit janar. Kjo periudhe karakterizohet me numer te vogel te diteve me mjegull, ku gjatë kësajë periudhe janë paraqitë vetëm dy ditë me mjegull .

Numri i diteve me reshje bore dhe shiu- gjatë kësajë periudhe është karakterizuar muaji mars me më së shumti ditë me reshje shiu kështu qe në Pejë janë regjistruar 19 ditë me reshje shiu, në Prishtinë 10 dhe në Ferizaj 9 ditë, ndërsa reshje bore ka pasë vetëm në muajin janar me përjashtim te Ferizajit ku është regjistruar 1 ditë me reshje bore gjatë muajit shkurt.

Reshjet – Tremujori i parë i vitit 2016 karakterizohet me reshje te bolleshme qe d.m.th se ka pase sasi te larte te reshjeve sidomos ne muajin marse. Sasia maksimale eshte regjistruar ne Peje me 175.8mm(l/m²)gjatë muajit mars,ndërsa sasia totale per kete periudhe ne Peje arrinë në 316.9mm(l/m²), në Prishtinë me 233.4 mm(l/m²) dhe në Ferizaj me 234mm(l/m²). Sipas shpërndarjes së përqindjet reshjet shkonin në kategorinë e normale dhe vende vende te lagësht (mbi normalen).

DUKURIT EKSTREME

PARAQITJA E THATËSIRAVE NË KOSOVË- INDEKSI STANDARD I PRECIPITIMIT(RESHJEVE)-SPI

Situata e thatësirav në lidhje me akumulimin e reshjeve është paraqitur nga Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI). Llogaritja e SPI është e bazuar në shpërndarjen e reshjeve mbi periudha të gjata kohore 30 vjet , ne këtë rast janë përdorur mesataret afatgjate (1926/1949-2016).

SPI mund të llogaritet në shkallë të ndryshme kohore te cilat pasqyrojnë ndikimin e thatësirës mbi disponueshmërinë e burimeve ujore.

Te dhënat për reshjet e regjistruara për një periudhë të gjatë kohore mundësonë një shpërndarje probabiliteti, e cila është normalizuar më pas në mënyrë që mesatarja SPI për çdo vend dhe periudhë kohore është zero. Vlerat e SPI mbi zero tregojnë periudha me lagështirë dhe vlerat nën zero tregojnë periudha të thata. Në vazhdim janë paraqitë tabelat e SPI për regjionin e rrafshit të Kosovës/pellgu i Ibrit- stac.në Prishtinë, regjionin e Dukagjinit/pellgu i Drinit të Bardhë- stac.në Pejë dhe pellgun e Lepencit-stac. në Ferizaj.

Year	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec
1974	-1.28	-0.67	-0.05	0.94	1.81	-0.91	0.16	-2.81	1.48	-0.22	1.68	-1.08
1975	0.78	1.17	0.70	1.48	0.30	0.68	0.16	0.70	1.14	1.15	0.00	1.01
1976	2.20	0.78	0.71	1.02	1.10	0.73	0.05	0.01	1.12	0.80	0.24	2.07
1977	0.74	0.25	0.78	0.75	0.83	0.72	0.72	0.70	0.72	0.72	0.72	0.72
1978	1.77	-0.21	-0.21	-0.1	-0.1	-0.9	-0.1	-0.0	-0.1	-0.0	-0.1	-0.1
1979	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
1980	-0.6	-0.0	-0.5	-0.0	-0.0	-0.0	-0.0	-0.0	-0.0	-0.0	-0.0	-0.0
1981	-0.6	-0.7	-0.5	-0.7	-0.5	-0.5	-0.5	-0.5	-0.5	-0.5	-0.5	-0.5
1982	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
1983	-0.6	-0.6	-0.5	0.0	-0.0	0.94	0.16	0.90	-0.42	1.47	1.90	-0.6
1984	0.46	0.0	0.6	2.14	-0.90	-0.85	-0.77	-0.94	-1.27	-0.07	-0.07	0.88
1985	1.70	0.70	0.09	1.77	0.00	0.78	0.00	0.77	0.78	0.77	0.78	0.77
1986	0.10	0.21	0.72	0.30	0.92	0.07	0.00	0.88	0.22	0.18	1.21	0.77
1987	0.00	0.00	0.81	0.78	1.28	1.29	0.07	0.72	0.05	0.15	1.24	-0.00
1988	0.71	-0.04	-0.94	-0.92	0.00	0.00	-0.00	-0.00	-0.00	-0.00	-0.00	-0.00
1989	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1990	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1991	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1992	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1993	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1994	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1995	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1996	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1997	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1998	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
1999	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2000	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2001	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2002	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2003	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2004	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2005	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2006	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2007	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2008	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2009	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2010	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2011	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2012	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2013	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2014	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2015	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2016	0.71	0.00	-0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

tabela.2. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) per Prishtinë

Tabela.3. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) per Ferizaj

Tabela.4. Indeksi i Standardizimit të Reshjeve (SPI) per Pejë

Nga tabelat e lartëshënuara vëreheët se gjatë periudhes Janar-Mars 2016 në tri regjionet e lartëpërmendura nuk është paraqitë dukuri e thatësirave . Indeksi i standardizimit të reshjeve(SPI) për tri regjionet , tregon se gjatë kësaj periudhe për të cilën jemi referuar është paraqitë periudhë me lagështi gjë qe na lenë të kuptojmë se gjatë kësaj periudhe ka pasë paraqitje te dukuris se vërshimeve, d.m.th ka suficit te ujrave në akumulacionet e reshjeve për këtë periudhë.

PARAQITJA E VËRSHIMEVE NË KOSOVË

Periodha për të cilën i referohet ky buletin është shoqëruar me reshje intensive të shiut, duke filluar nga data **05/01/2016** ku ka arritur maksimumin gjatë datës **06/01/2016**, me intensitet me të theksuar të shpërndarjes kohore dhe hapësinor sidomos në pjesën perëndimore dhe qendrore të Gadishullit Ballkanik.

Këto të reshura, kanë shkaktuar ngritjen e shpejt të nivelit të ujit në lumenjtë e Kosovës, të cilët janë të vrullshëm, për shkak të karakterit malorë të tyre, ku si pasojë shumica e tyre kanë dalur nga shtrati duke shkaktuar përmbytje në disa zona të Kosovës. Ngritjen e shpejtë të nivelit të ujrave në lumenjë e ka ndihmuar edhe situata sinoptike, e cila ka dominuar gjatë kësaj periudhe ku janë regjistruar temperaturat e ajrit prej $+5^{\circ}\text{C}$, të cilat kanë kushtëzuar shkrirjen më intensive të borës, trashësia e së cilës në Prishtinë kishte arritur 13 cm.

Kjo situatë e përcjellur, me reshje shiu në viset e ulëta, ndërsa në ato malore reshje bore, ka ndikuar në përkeqësimin e situatës me vërshime⁴.

Situata hidrologjike ishte pothuajse e njëjtë në tërë territorin e Kosovës, por më tepër e rënduar në pellgun e Drinit të Bardhë, duke përfshi shumicën e ujërrjedhave të sajë nga të dyja anët. Problematike paraqiteshin rrjedhat malore me karakter rrëkesh (përroskat, përrojet) etj të cilat për shkak të konfiguracionit të relievit, kanë karakter vërshues duke shkaktuar dëme nëpër disa fshatra dhe lagje qytetesh, në disa vise të Kosovës.

Vetëm gjatë 24 orëve të fundit të datës **06/01/2016**, situata hidrologjike në lumenjtë kryesorë të Kosovës ka qenë si në vijim⁵:

1. Drini Bardhë/Gjonaj nga 1.60 në 2.50 m
2. Drini i Bardhë/Këpuz nga 0.92 - 1.10 m
3. Bistrica Pejes/Grykë e Rugoves – 0.38 – 0.60
4. Lepenci/Hani Eelezit nga 0.46 – 0.70 m
5. Morava Binçes/Knonçu; nga 2.24 – 2.60 m
6. Ibri/Leposaviq nga 1.41 – 1.45 m
7. Sitnica/Nedakoc nga 1.38 – 1.43 m

Nga data **07-08-09/01/2016**, niveli dhe prurjet e ujit nëpër shumicën e lumenjve të Kosovës janë karakterizuar me rritje graduale, kjo situatë ka vazhduar deri më datën **10/01/2016**, kur nivelet e ujit nëpër ujërrjedha gradualisht filluan të uleshin.


⁴ Për më tepër, shih raportin: <http://ëëë.ammk-rks.net/?page=1,7,337>
<http://ëëë.ammk-rks.net/?page=1,7,346>

⁵ Të dhënat janë transferu në kohë reale nga stacionet hidrometrike në softëverin qendrorë në IHMK përmes GPRS, në interval kohorë të matjeve çdo 15 min.

Edhe muaji mars karakterizohet më vërshime, kur Kosova, që nga datë **07/03/2016**, duke filluar pas orës **03.00 a.m.** u përfshi nga reshjet e shiut, fillimisht pjesa veri-perëndimore, për tu përfshirë më pas tërë vendi. Sasia e reshjeve ishte rreth 15 – 20 mm brenda 6 orëve. për të arritur maksimumin e intensitet me rreth 30 mm (l/m^2), brenda 6 orëve. Gjendje e tillë kishte vazhduar deri më datë **08/03/2016**.

Nga këto reshje niveli nëpër lumenj filloj të rritej shpejt, ndërsa atyre me karakter malorë ishte më i vrullshëm, ku si pasojë filloj të ketë vërshime si dhe rrëshqitje të tokës.

Nivlet më të larta absolute të regjistruara gjatë periudhës janar – shkurt – mars, në pellgun e Drinit të Bardhë kanë arritur gjatë datës **08/03/2016**, Ibi në mesë **11-14/03/2016**, Moraven e Binçs nga **07 deri 11/03/2016** dhe në Lepenc më 07-08/03/2016.



Grafiku 3. Raporti në mese niveleve mesatare dhe maksimale gjatë periudhes I-III

Nivelet më të larta gjatë këtyre muajve sidomos gjatë muajit mars, janë regjistruar në Moravën e Bincës, ku më datën 11.3.2016, ka arritur 610 cm, pastaj Drini Bardhë më datën 08.03.2016 në Gjonaj ka arritë në 500 cm dhe Këpuz 450 cm. Ibi në Leposavic me amplitudë 400 cm, më datë 13.3.2016, dhe Lepenci 150 cm, më 7.3.2016.

Siq është përmend edhe më lartë kjo periudhë është karakterizuar me vërshime po thujse ne te gjitha komunat e Kosovës. Përkeqsimit të gjendjes me vërshime i kontribuan edhe infrastruktura jo adekuate e kanalizimeve në vendëbanime dhe infrastruktura e shtreterve te lumenjeve. Në rastet e vërshimeve në muajin janar dhe marsë dolën nga shtrati lumenjë: Sitnica, Drenica, Ibi,

Krivareka, Morava dhe degët e lumit Drini i Bardhë (Mirusha dhe Toplluha). Ne këtë rsatë vërshime më te mëdha ka pasë në komunën e Malishevës , Drenasit dhe Fushë Kosovës (fig.1, 2dhe 3).



*Fig,1 Pamje nga vershimet në Malishevës-
lumi Mirusha, 06.01.2016*



*Fig,2 Pamje nga vershimet në Drenas-
lumi Drenica,06.01.2016*



*Fig. 3.Pamje nga vërshimet në Fushë Kosovë-lumi
Sitnica,07.03.2016*

BULETINI HIDRO-KLIMATOLOGJIK- TREMUJORI I PARË 2016, Nr.1

Publikuar nga:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencioni i Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Buletini Hidro-Klimatologjik - tremujori i parë 2016, nr.1- Është përgatitur nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës .

Përgatitja e buletinit është realizuar nga:

Ing.e dipl./Msc. Letafete LATIFI, *Drjetore e IHMK;*
Dr.sci. Bashkim KASTRATI, *Hidrolog i lartë ne IHMK;*
Besim ALIU, *Meteorolog në IHMK, stc.në Ferizaj.*

Kontribues në përgatitjen e buletinit janë zyrtarët e hidrologjisë dhe meteorologjisë:

Xhevahire Puraj, *Hidrologe;*
Ing i dipl./Msc. Hasan Hasani, *Hidrolog i lartë;*
Faton Sopi, *Administrator në databazë;*
Beqir Gashi , *Meteorolog, stac. Në Prishtinë*
Bardhyl Ahmetxhekaj,*Meteorolog, stc.në Pejë*
Avdyl Rama, *bashkëpunëtor në meteorologji.*